

Jeanes Plouze
[Signature]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI



Tiranë, më 15.12.2023

Lënda: Nismë për propozim projektligji “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar.

Drejtuar: Znj. Lindita NIKOLLA
KRYETARE E KUVENDIT

E nderuara Zonja Kryetare,

Në mbështetje të nenit 81, pika 1 dhe 2 të Kushtetutës dhe nenit 68 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e deputetit, paraqes për shqyrtim dhe miratim në Kuvend, nismën për propozimin e projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar.

Qëllimi i propozimit është kryerja e disa ndryshimeve në Ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, të cilat synojnë rregullime në ligjin ekzistues, me qëllim aplikimin në mënyrë të drejtë, korrekte dhe pa ambiguitet të dispozitave ligjore. Kjo bën të mundur në anën tjetër, rregullimin dhe përmirësimin e procedurave të Ligjit të Koncesioneve.

Lutemi gjeni bashkëlidhur tekstin e projektligjit të propozuar si dhe relacionin shoqërues të tij.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin,

Me respekt,

Deputeti propozues

Laert Duraj
[Signature]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKT LIGJ

Nr. _____/2023

PËR

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 125/2013 "PËR KONCENSIONET DHE
PARTNERITETIN PUBLIK PRIVAT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e njw deputeti, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

VENDOSI:

Në ligjin nr. 125/2013 "Për koncensionet dhe partneritetin publik privat", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 5, shkronja "i" ndryshohet si më poshtë vijon:

i) për ndërtimin dhe shfrytëzimin e burimeve të energjisë së rinovueshme, sipas përcaktimeve të ligjit nr.24/2023 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", përveç hidrocentraleve.

Neni 2

Nw nenin 19, pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

"1) Studimi i fizibilitetit për koncensionin /partneritetin publik privat hartohet nga komisioni i dhënies së koncensionit /partneritetit publik privat brenda 60 ditëve pune nga vendimi i Autoritetit

Kontraktues për vazhdimin e procedurave. Ky afat mund të shtyhet për shkaqe të kompleksitetit të projektit me jo më shumë se 30 ditë pune”.

Neni 3

Në nenin 28, pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

1. Para nënshkrimit ose hyrjes në fuqi të kontratës, autoriteti kontraktues merr nga ofertuesi më i suksesshëm garancintë e kërkuara për realizimin e kontratës dhe instrumentat e sigurisë si kompensim për dëmin që mund të shkaktohet si pasojë e dështimit të koncesionarëve /partnerëve privatë për të përmbushur detyrimet e parashikuara në kontratë (premtim për pagesë, garanci bankare, garanci të korporatës, kambiale etj).

1/1. Sigurimi i kontratës koncesion i shërbimeve publike përcaktohet në dokumentat e tenderit dhe do të jetë deri në 5% të vlerës së kontratës. Kjo masë mund të reduktohet në mënyrë përpjestimore gjatë ekzekutimit të kontratës, por, në asnjë rast, gjatë kohëzgjatjes së saj, nuk mund të jetë më e vogël se 25% e vlerës fillestare të sigurimit.

1/2. Sigurimi i kontratës koncesion i punëve publike, përcaktohet në dokumentat e tenderit dhe do të jetë deri në 5% të vlerës së ndërtimit, ndërsa pas periudhës së ndërtimit, do të jetë deri në 5% të vlerës së mbetur të kontratës.

Neni 4

Në nenin 36, fjalia e parë e pikës 1, ndryshohet si më poshtë vijon:

1. Përveç rasteve të parashikuara në kontratë, autoriteti kontraktues mund të ndërpresë kontratën kur:

KRYETARI

LINDITA NIKOLLA

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN

PËR

DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 125/2013 “PËR KONCENSIONET DHE PARTNERITETIN PUBLIK PRIVAT”, TË NDRYSHUAR

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ndryshimet e propozuara synojnë rregullime në Ligjin ekzistues nr. 125/2013, “Për koncensionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar. Marrja e kësaj nisme bëhet me qëllim aplikimin në mënyrë të drejtë, korrekte dhe pa ambiguitet të dispozitave ligjore, duke bërë kështu të mundur rregullimin dhe përmirësimin e procedurave të Ligjit të koncensioneve nr. 125/2013.

Si e tillë, në mënyrë adresimin e këtyre problematikave që janë vërejtur gjatë zbatimit të ligjit në fuqi, propozohen disa shtesa dhe ndryshime me qëllim përmirësimin dhe rritjen e efektivitetit të procedurave që rrjedhin nga ky ligj.

Ky projektligj vjen si domosdoshmëri për të përmirësuar procesin e koncensioneve në vend. Në praktikën e përditshme procedurale të dhënies me koncension sipas parashikimeve ligjore, me qëllim nxitjen e investimeve po dhe krijimin e lehtësive për to, janë konstatuar çështje të cilat janë të nevojshme të adresohen nëpërmjet një nisme ligjore.

II. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Kontratat koncensionare konsiderohen si instrumente të rëndësishme në zhvillimin afatgjatë të infrastrukturës dhe investimeve strategjike, duke mundësuar kështu që qytetari të përfitojë nga ekspertiza dhe shërbimet e sektorit privat. Nga praktika e deritanishme kjo formulë, ka pasur problematika të cilat kanë bërë që procedurat të mos jenë eficiente. Nga zbatimi në praktikë i ligjit, mënyra e përlllogaritjes së garancisë së realizimit të kontratës ka rezultuar në vlera mjaft të larta të cilat pengojnë financimin real të projektit që synon të zhvillohet.

Në këtë kuptim, duhet të bëjmë të mundur që rregullimet ligjore të jenë sa më të qarta, në harmoni me nivelin e BE-së, që të mos krijohen pasiguri dhe pengesa ligjore për ofrimin e lirë të shërbimeve nga privatët, për garantimin e sigurt të zhvillimit të investimit deri në përfundimin final të projektit.

Bazuar edhe në rastet konkrete apo problematikat e hasura, për të dalë nga situata e krijuar, duhet të ndërhyhet në ato parashikime ligjore me qëllim që operatorëve ekonomikë të mos u krijohen pengesa dhe barrë të shtuara gjatë gjithë procesit të koncensionit si dhe të kenë akses sa më të thjeshtë dhe jo diskriminues.

Si e tillë në koncensionet e përzier, objekti i të cilave është kryerja e punimeve po dhe sigurimi i shërbimeve, dhe që identifikohen si koncension i punëve publike, elementi punë që do të kryhet, identifikohet si objekti kryesor i kontratës.

Theksoj se në përgjithësi këto investime të materializuara në kontrata kanë vlera shumë të larta dhe konkretisht garancitë që kërkohen lidhen me garanci që duhet të sigurohen dhe të vijohen nga shteti në rast të dështimit të koncensionarëve për të përmbushur detyrimet e parashikuara në kontratë.

Në këtë mënyrë vlerësohet se do të ishte më efiçiente ndarja e këtyre parashikimeve përsa i përket garancisë me qëllim adresimin dhe zgjidhjen në praktikë të problematikave. Konkretisht, parashikimet për sigurimin e kontratave të punëve duhet t'i japin prioritet garancisë së lidhur me periudhën e ndërtimit të objektit të kontratës së koncensionit.

Pra, në pikën 1 të nenit 28, të Ligjit 12/2013, të ndryshuar, të bëhet nëndarja 1/1 dhe 1/2:

1/1. Sigurimi i kontratës së shërbimeve do të jetë deri në 5% të vlerës së kontratës dhe përcaktohet në dokumentat e tenderit. Kjo masë mund të reduktohet në mënyrë përpjestimore gjatë ekzekutimit të kontratës, por, në asnjë rast, gjatë kohëzgjatjes së saj, nuk mund të jetë më e vogël se 25% e vlerës fillestare të sigurimit.

1/2 Sigurimi i kontratës së punëve do të përfshijë vlerën e investimit gjatë periudhës së ndërtimit dhe pas kësaj periudhe për vlerën e mbetur të kontratës si dhe duke hequr cilësimin për masën e reduktimit - që nuk mund të jetë më i vogël se 25% e vlerës fillestare të sigurimit.

Në të cilën të përcaktohet qartë përlllogaritja për secilin sigurim më vete, atë të kontratës së shërbimeve dhe të kontratës së punës më vete.

Sa më sipër, duke marrë në konsideratë se vetë Direktiva e Koncensionëve thekson lirinë e shteteve anëtare për të strukturuar ofrimin e punëve apo shërbimeve sipas

nevojave të tyre, vlerësojmë se ky propozim është në përputhje me të, si dhe ka ardhur si pasojë e zbatimi të legjislacionit kombëtar në fuqi.

Sa i përket ndryshimeve referuar studimit të fizibilitetit, sqarojmë se aktualisht studimi i fizibilitetit për koncensionin/partneritetin publik privat hartohet nga komisioni i dhënies koncesionit/partneritetit publik privat brenda 60 ditëve pune nga krijimi i këtij komisioni. Por nisur nga problematikat e hasura, dhe kompleksitetit të projekteve sepse lidhen pothuajse të gjitha me infrastrukturë të rëndësishme, nevojitet që koha në dispozicion për studimin të jetë 60 ditë nga dhënia e miratimit nga Autoriteti Kontraktues. Ky ndryshim do të kishte impakt pozitiv në përmirësimin e cilësisë së projektit.

- Meqenëse ndërtimi i hidrocentraleve mbi 2 MW përjashtohen nga zbatimi i kërkesave të VKM nr. 822, datë 07.10.2015 “Për miratimin e rregullave dhe të procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike të cilat nuk janë objekt koncesioni”, e ndryshuar, rrjedhimisht ky fakt duhet reflektuar dhe në Ligjin e koncesioneve.
- Duke qene se kontratat e punëve publike në përgjithësi kanë vlera shumë të larta të cilat lidhen me ndërtimin e objektit kontratë koncesioni, parashikimet për sigurimin e kontratave për punët publike të ndahen nga garancitë për fazën e shërbimit. Sigurimi i kontratës për punët publike të vijojë me sigurimin e vlerës së mbetur të investimit duke bërë kështu përshkallëzim të vlerës së sigurimit të kontratës.

III. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS DHE NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj që propozohet del në mbështetje të neneve 78, 81 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti.

IV. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ky projektligj parashikon disa shtesa dhe ndryshime në dispozitat e Ligjit ekzistues nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, si më poshtë vijon:

✓ Neni 1 parashikon ndryshime në nenin 5:

Ishte: i) për ndërtimin dhe shfrytëzimin e burimeve të energjisë së rinovueshme, sipas përcaktimeve të ligjit nr.138/2013 “Për burimet e rinovueshme të energjisë”, përveç hidrocentraleve me kapacitet të instaluar mbi 2 MË.

Bëhet: i) për ndërtimin dhe shfrytëzimin e burimeve të energjisë së rinovueshme, sipas përcaktimeve të ligjit nr.24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, përveç hidrocentraleve.

✓ Neni 2 parashikon ndryshime në pikën 1, të nenit 19:

Ishte: “1. Studimi i fizibilitetit për koncensionin /partneritetin publik privat hartohet nga komisioni i dhënies së koncensionit /partneritetit publik privat brenda 60 ditëve pune nga krijimi i këtij komisioni. Ky afat mund të shtyhet për shkaqe të kompleksitetit të projektit me jo më shumë se 30 ditë pune”.

Bëhet: “1. Studimi i fizibilitetit për koncensionin /partneritetin publik privat hartohet nga komisioni i dhënies së koncensionit /partneritetit publik privat brenda 60 ditëve pune nga vendimi i Autoritetit Kontraktues për vazhdimin e procedurave. Ky afat mund të shtyhet për shkaqe të kompleksitetit të projektit me jo më shumë se 30 ditë pune”.

✓ Neni 3 parashikon ndryshime në pikën 1, të nenit 28:

Ishte: “1. Para nënshkrimit ose hyrjes në fuqi të kontratës, autoriteti kontraktues merr nga ofertuesi më i suksesshëm garancitë e kërkuara për realizimin e kontratës dhe instrumentat e sigurisë si kompensim për dëmin që mund të shkaktohet si pasojë e dështimit të koncensionarëve / partnerëve privatë për të përmbushur detyrimet e parashikuara në kontratë (premtim për pagesë, garanci bankare, garanci të korporatës, kambiale etj). Sigurimi i kontratës do të jetë deri në 5% të vlerës së kontratës dhe përcaktohet në dokumentat e tenderit. Kjo masë mund të reduktohet në mënyrë përpjestimore gjatë ekzekutimit të kontratës, por në asnjë rast, gjatë kohëzgjatjes së saj, nuk mund të jetë më e vogël se 25% e vlerës fillestare të sigurimit.

Bëhet:

“1. Para nënshkrimit ose hyrjes në fuqi të kontratës, autoriteti kontraktues merr nga ofertuesi më i suksesshëm garancitë e kërkuara për realizimin e kontratës dhe instrumentat e sigurisë si kompensim për dëmin që mund të shkaktohet si

pasojë e dështimit të koncesionarëve /partnerëve privatë për të përmbushur detyrimet e parashikuara në kontratë (premtim për pagesë, garanci bankare, garanci të korporatës, kambiale etj).

1/1. Sigurimi i kontratës koncesion i shërbimeve publike përcaktohet në dokumentat e tenderit dhe do të jetë deri në 5% të vlerës së kontratës. Kjo masë mund të reduktohet në mënyrë përpjestimore gjatë ekzekutimit të kontratës, por në asnjë rast, gjatë kohëzgjatjes së saj, nuk mund të jetë më e vogël se 25% e vlerës fillestare të sigurimit.

½. Sigurimi i kontratës koncesion i punëve publike përcaktohet nën dokumentat e tenderit dhe do të jetë deri në 5% të vlerës së ndërtimit, ndërsa pas periudhës së ndërtimit, do të jetë deri në 5% të vlerës së mbetur të kontratës.

✓ Neni 4 parashikon ndryshime në pikën 1 të nenit 36.

Ishte:

1. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, autoriteti kontraktues mund të ndërpresë kontratën kur:

Bëhet:

1. Përveç rasteve të parashikuara në kontratë, autoriteti kontraktues mund të ndërpresë kontratën kur:

V. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT.

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe të gjitha autoritetet që miratojnë / zbatojnë kontrata koncesionesh /PPP.

VI. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT.

Ky projektligj është nismë deputi.

VII. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE.

Ky projekt-ligj nuk krijon efekte financiare shtesë në buxhet. Ndryshimet e propozuara janë të aspektit teknik dhe procedural.